



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA  
KOMISIONI I PAVARUR I MEDIAVE  
NEZAVISNA KOMISIJA ZA MEDIJE  
INDEPENDENT MEDIA COMMISSION



“Company 21” Sh.p.k.  
Numri i biznesit - 70124965  
Drejtoreshë – Afërdita KELMENDI  
OSHMA 21 POPULLORE  
Pallati i Mediave/Aneksi 2  
Prishtinë

Ref:1812/1306/LIC/ni

### VENDIM

*për ripërtëritjen e licencës të Ofruesit të Shërbimeve Mediale Audiovizuale me transmetim përmes operatorëve të shpërndarjes 21 Popullore, me seli në Prishtinë*

### FAKTET

1. Komisioni i Pavarur i Mediave (KPM), në bazë të nenit 3, paragrafi 2.6. të ligjit për KPM (Ligji nr. 04/L-44), nxjerr akte nënligjore për rregullimin e transmetimit dhe të shërbimeve mediale audio-vizuale, të cilat nevojiten për të kryer funksionet e saj në pajtim me standardet ndërkombëtare.
2. 21 Popullore është Ofrues i Shërbimeve Mediale Audiovizuale (OSHMA), i cili është licencuar nga Komisioni i Pavarur për Media (KPM), për transmetimin e programeve televizive përmes sistemit të operatorëve të shpërndarjes. KPM, me datën 4 dhjetor 2008, ka marr vendim për dhënien e licencës për OSHMA 21 Popullore.
3. Me datën 4 dhjetor 2018, skadon afati i licencës së 21 Popullore, ndërsa, në bazë të nenit 25 të Ligjit për KPM-në, kandidati i ofrohet e drejta të kërkojë ripërtëritjen e licencës në afat brenda gjashtë (6) muajve para skadimit të datës së licencës ekzistuese dhe minimum gjashtëdhjetë (60) ditë para skadimit të licencës.
4. Më 29 qershor 2018, Departamenti i Licencimit, pranë Zyrës Ekzekutive të KPM-së, i ka njoftuar të gjithë të licencuarit si Ofrues të Shërbimeve Mediale Audiovizuale me transmetim përmes operatorëve të shpërndarjes, të cilëve afati i licencës ju skadon në vitin 2018, lidhur me afatet dhe obligimet që parashihen me nenin 25 të Ligjit për KPM, për ripërtëritje të Licencës së KPM-së.
5. Më 2 tetor 2018, 21 Popullore ka parashtruar kërkesën në zyrën e KPM-së, me anë të së cilës ka shprehur interesimin për ripërtëritje të Licencës së KPM-së.

## ARSYETIMI

- Komisioni konstaton se, OSHMA 21 Popullore, ka parashtruar kërkesën për ripërtëritje të licencës së KPM-së brenda afatit të përcaktuar ligjor dhe në pajtim të plotë me procedruat e përcaktuara administrative nga KPM.
- Neni 25 i Ligjit për KPM-në, i cili thekson:

*“Përveç rasteve kur KPM-ja konsideron se licenca nuk duhet të ripërtëritet për shkak të shkeljes së dispozitave materiale nga ana e ofruesit të shërbimit medial audiovizuel privat për sa u përket kushteve dhe kriterëve të licencimit, kandidati ka të drejtë të kërkojë përtëritjen e licencës nga Zyra Ekzekutive brenda gjashtë (6) muajve para skadimit të datës së licencës ekzistuese dhe minimum gjashtëdhjetë (60) ditë para skadimit të licencës”,*

krijon bazën ligjore që të ripërtërijë licencën e kandidatëve të cilët kanë parashtruar kërkesën për ripërtëritje në pajtim me ligjin për KPM.

## VENDIM

- Komisioni, në takimin e tij të mbajtur më datën 21 dhjetor 2018, në pajtim me Nenin 25 të Ligjit për KPM-në, merr vendim për ripërtëritjen e licencës së 21 POPULLORE, për të ushtruar veprimtarin si ofrues i shërbimeve mediale audiovizuale, me transmetim përmes operatorëve të shpërndarjes, në Republikën e Kosovës.
- Licenca e KPM-së për OSHMA 21 Popullore do të jetë e vlefshme në afat prej 10 (dhjetë) viteve, bazuar në Nenin 21, paragrafin 2 të Ligjit për KPM-në, ndërsa, vlefshmëria e licencës do të llogaritet nga data 4 dhjetor 2018.
- Të gjitha parametrat e Licencës së KPM-së, të OSHMA 21 Popullore, mbesin të pandryshuara nga licenca paraprake.
- Këtë vendim e lëshon Komisioni, dhe i njëjti hyn në fuqi që nga data e nënshkrimit.



Muja FERATI

Kryetar

KOMISIONI I PAVARUR I MEDIAVE



21.12.2018

datë